



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 5.5.2023

Nr: 446

Ora: 12:30

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E KËRKESAVE TË TELEVISIONIT “TOP CHANNEL”, BBF TELEVISION, TELEVISIONI  
“FAX MEDIA NEWS”, TV KOPLIKU, PËR VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE PËR ORGANET E QEVERISJES  
VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot në datën 5.5.2023, unë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtova kërkesat e:

- KËRKUES:** Televizioni “Top Channel”, me adresë Rruga “ 17 Nëntori”, Nr. 20, Mëzez Kodër, Kashar, Tiranë dhe me përfaqësues z. Altin Krekas;
- Televizioni “BBF”, me adresë Rruga e Kavajës, Qendra “Kondor Tiranë” nr. 5, Tiranë dhe me përfaqësues z. Fejzo Subashi;
- Televizioni “FAX MEDIA NEWS”, me adresë Rruga “Kostaq Capo”, Lagjja “Ali Demi” Tiranë dhe me përfaqësues z. Kevin Hysenbelli;
- Televizioni “TV KOPLIKU”, me adresë Qendër, Koplik dhe me përfaqësues z. Zenel Hoxhaj;

**OBJEKTI:** Kërkohet akreditimi i përfaqësuesve të Medias për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023

**BAZA LIGJORE:** Nenet 6, 7 e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe vendimi nr. 19, datë 27.01.2023, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, dhe mediave”.

Data: 5.5.2023 Nr: 446  
Ora: 12:30



“Për shqyrtimin e kërkesave të Televizionit “Top Channel”, BBF Television, Televizioni “Fax Media News”, TV Kopliku, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

## V Ë R E J:

Televizioni "Top Channel" i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën si dhe dokumentacionin përkatës për 98 (nëntëdhjetë e tetë ) gazetarë dhe operatorë si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Televizioni "Top Channel" është subjekt, i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

Televizioni "BBF" i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën si dhe dokumentacionin përkatës për 1 (një) gazetar si dhe zonat e vëzhgimit të tij. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Televizioni "BBF" është subjekt, i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

Televizioni "FAX MEDIA NEWS" i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën si dhe dokumentacionin përkatës për 41 (dyzetë e një) gazetarë si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Televizioni "FAX MEDIA NEWS" është subjekt, i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

Televizioni "TV KOPLIKU" i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën si dhe dokumentacionin përkatës për 9 (nëntë) gazetarë si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Televizioni "TV KOPLIKU" është subjekt, i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

## P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në nenet 6, 7 e 19, pikat 1, shkronja "n", e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, dhe vendimin nr. 19, datë 27.01.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, "Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, dhe mediave",

## V E N D O S:

1. Akreditimin e 98 (nëntëdhjetë e tetë) gazetarëve dhe operatorëve të Televizionit "Top Channel", për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Akreditimin e 1 (një) gazetari të Televizionit “BBF”, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Akreditimin e 41 (dyzetë e një) gazetarëve të Televizionit “FAX MEDIA NEWS”, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
4. Akreditimin e 9 (nëntë) gazetarëve të Televizionit “TV KOPLIKU”, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**